



Ambasciata d'Italia
Pristina

THIRRJE PUBLIKE PËR SPONSORIZIM ME RASTIN E PRITJES PËR FESTËN E REPUBLIKËS 2026 NË KOSOVË

Ambasadori i Italisë në Kosovë

- DUKE PASUR PARASYSH** nenin 43 të ligjit nr. 449, datë 27 dhjetor 1997, i cili, me qëllim nxitjen e inovacionit në organizimin administrativ dhe realizimin e kursimeve më të mëdha, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, autorizon administratat publike të lidhin kontrata sponsorizimi dhe marrëveshje bashkëpunimi me subjekte private, me kusht që iniciativat objekt i këtyre kontratave të jenë të orientuara drejt interesit publik, të përjashtojnë konfliktin e interesit ndërmjet veprimtarisë publike dhe asaj private dhe të sjellin kursime në shpenzime krahasuar me fondet e parashikuara;
- DUKE PASUR PARASYSH** Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 54, datë 1 shkurt 2010, që përmban norma mbi autonominë menaxheriale dhe financiare të përfaqësive diplomatike dhe zyrave konsullore të kategorisë së parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, i cili në nenin 29 parashikon që zyrat jashtë vendit mund të lidhin kontrata sponsorizimi me subjekte publike ose private, ndërmarrje, shoqata, fondacione, qytetarë dhe në përgjithësi me çdo subjekt, italian apo i huaj, që nuk ushtron veprimtari në konflikt me interesin publik, me kusht që këto kontrata të përjashtojnë konfliktin e interesit ndërmjet veprimtarisë publike dhe asaj private;
- DUKE PASUR PARASYSH** nenin 6 të D.M. nr. 192, datë 2 nëntor 2017;
- DUKE MARRË PARASYSH** se Ambasada e Italisë në Prishtinë luan një rol parësor në kuadër të Sistemit Itali në Kosovë (rrjet institucional dhe ekonomik), në mbështetje të ndërmarrjeve dhe institucioneve italiane, italo - kosovare dhe ndërkombëtare të lidhura në mënyra të ndryshme me Italinë, si dhe interesin e shprehur nga disa ndërmarrje italiane dhe të huaja për të mbështetur nisma të promovimit të integruar tregtar, kulturor dhe shkencor në bashkëpunim me Ambasadën, duke pasur mundësi të promovojnë imazhin e tyre dhe të sponsorizojnë aktivitetet e lidhura me kremtimet e Festës së Republikës;

BËN TË DITUR

që synon t'u ofrojë subjekteve të interesuara mundësinë për të lidhur kontrata sponsorizimi me rastin e pritjes për Festën e Republikës 2026, për subjekte publike apo private që, përmes një pagese në para dhe/ose kontributeve në natyrë, dëshirojnë të promovojnë imazhin e tyre përmes publikimit të logos së tyre ose përmes formave të tjera të përshtatshme të komunikimit.

NENI 1 – OBJEKTI

Me rastin e kremtimeve të Festës së Republikës Italiane 2026, Ambasada e Italisë në Prishtinë parashikon të organizojë një aktivitet institucional dhe promovues, si dhe të realizojë aktivitetet përkatëse të komunikimit.

NENI 2 – KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SPONSORIZIM

Kanë të drejtë të paraqesin oferta sponsorizimi të gjitha subjektet publike ose private, ndërmarrjet, shoqatat dhe fondacionet jofitimprurëse, si dhe çdo subjekt tjetër, italian apo i huaj, që nuk ushtron veprimtari në konflikt me interesin publik.

Sponsorët duhet të plotësojnë këto kushte:

- përputhje me interesin publik dhe që nuk bëjnë pjesë në organizata me natyrë politike, sindikale ose fetare;
- nuk ka konflikt interesi ndërmjet veprimtarisë publike dhe asaj private që është objekt i sponsorizimit ose reklamimit;
- nuk shkakton cenim apo dëmtim të imazhit të Ambasadës së Italisë në Prishtinë ose të nismave të saj;
- nuk ka kontest gjyqësor me institucionin propozues;
- nuk ka pengesa ligjore që kufizojnë aftësinë për të lidhur kontrata;
- nuk është në procedurë falimentimi apo procedura të ngjashme.

NENI 3 – ELEMENTET E MARRËVESHJES SË SPONSORIZIMIT

Sponsorizimi ka për qëllim të sigurojë burimet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara në nenin 1. Ambasada e Italisë në Prishtinë mund të lejojë pjesëmarrjen e më shumë se një sponsori. Marrëdhëniet ndërmjet Ambasadës dhe sponsorëve do të rregullohen me kontrata të veçanta, të lidhura në përputhje me legjislacionin italian në fuqi dhe praktikat vendore. Shpenzimet që lidhen me furnizimet e mundshme, si dhe pagesa e çdo tatimi, takse apo detyrimi tjetër, sipas legjislacionit kombëtar ose vendor, që rrjedhin nga zbatimi i kontratës, mbeten në ngarkim të sponsorit. Subjektet e përzgjedhura si sponsorë do të angazhohen të kontribuojnë me një shumë monetare në favor të Ambasadës së Italisë në Prishtinë, ose të ofrojnë shërbime apo furnizime, në këmbim të promovimit të markës së tyre tregtare me rastin e aktivitetit të sponsorizuar, sipas mënyrave që do të dakordohen në përputhje me nivelin e kontributit financiar në aktivitet.

Promovimi i markës mund të përfshijë:

- publikimin e markës/logos në komunikimet që lidhen me aktivitetin, përmes faqes zyrtare të Ambasadës dhe profileve të saj institucionale në rrjetet sociale;
- vendosjen e markës/logos në faqen e internetit të Ambasadës së Italisë në Prishtinë, në seksionin kushtuar aktivitetit të sponsorizuar, me lidhje (link) drejt faqes së internetit të sponsorit;

- përfshirjen e markës/logos në program dhe në një “thank you card” që u dërgohet së bashku me ftesën të gjithë pjesëmarrësve të mundshëm në pritjen e organizuar nga Ambasada;
- në varësi të llojit të sponsorit: vendosja e logos në “banner”-at e vendosur në hyrje dhe pranë skenës; vendosja e logos, në përmasa të mëdha, në panelin që shërben si sfond në zonën e hyrjes, ku bëhet pritja e të ftuarve dhe realizohen fotografitë; vendosja e logos në panelin që shërben si sfond i skenës, ku mbahen fjalimet zyrtare; si dhe mundësia eventuale për shpërndarjen e materialeve promovuese, sipas mënyrave që do të koordinohen në përputhje me kërkesat logjistike dhe standardet e paraqitjes.

NENI 4 – LLOJET E SPONSORËVE DHE KONTRIBUTI MINIMAL

Sponsorizimi i jep sponsorit të drejtën për një paraqitje të përshtatshme të logos së tij (“hapësirë promovuese”) gjatë zhvillimit të aktivitetit. Në varësi të kontributit të ofruar, përcaktohen këto kategori sponsorizimi:

- “Gold Sponsor” (ose “Sponsor Kryesor”): për kontribute prej të paktën 2.000,00 euro (dymijë/00);
- “Silver Sponsor”: për kontribute prej të paktën 1.000,00 euro (njëmijë/00);
- “Food & Beverage ose Services Gold Sponsor”: për ofrime në natyrë të ushqimeve të gatshme për konsum dhe/ose pijeve apo shërbimeve teknike, me vlerë të paktën 2.000,00 euro (dymijë/00), të dëshmuara drejtpërdrejt përmes dokumentacionit përkatës fiskal të blerjes;
- “Food & Beverage ose Services Silver Sponsor”: për ofrime në natyrë të ushqimeve të gatshme për konsum dhe/ose pijeve apo shërbimeve teknike, me vlerë të paktën 1.000,00 euro (njëmijë/00), të dëshmuara drejtpërdrejt përmes dokumentacionit përkatës fiskal të blerjes;
- “Food & Beverage ose Services Sponsor”: për ofrime në natyrë të ushqimeve të gatshme për konsum dhe/ose pijeve apo shërbimeve teknike, me vlera më të ulëta se ato të përcaktuara në pikat c) dhe d). Këto oferta mund të pranohen, duke u vlerësuar në mënyrë krahasuese sipas llojit dhe vlerës së produkteve të ofruara.

Shumat e mësipërme kuptohen pa përfshirë shpenzimet bankare.

NENI 5 – PARAQITJA E OFERTAVE TË SPONSORIZIMIT

Oferta për sponsorizim nga subjektet e interesuara duhet të paraqitet me shkrim, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor në rastin e personave juridikë, e shoqëruar me kopje të një dokumenti të vlefshëm identifikimi, dhe të dorëzohet përmes shërbimit postar, postës së regjistruar ose një korrieri të autorizuar, apo dorazi në këtë adresë: Ambasada e Italisë, Mujo Ulqinaku 9, Pejton, 10000 Prishtinë, brenda datës 5 maj 2026. Si alternativë, oferta mund të dërgohet edhe me e-mail në pristina.commerciale@esteri.it, po ashtu brenda datës 5 maj 2026.

Oferta, sipas modelit të bashkëngjitur në këtë njoftim, duhet:

- të përmbajë të dhënat e përgjithshme të sponsorit (person fizik ose juridik);
- të përcaktojë shumën financiare që propozohet për sponsorizim, ose, në rastin e sponsorizimeve në natyrë, përshkrimin e detajuar të mallrave/shërbimeve të ofruara;
- të përfshijë pranimin e kushteve të përcaktuara në këtë njoftim;

- të shoqërohet me një vetëdeklarim që vërteton mungesën e rrethanave që cenojnë ose kufizojnë aftësinë për të lidhur kontrata, në përputhje me nenet 94–98 të DL nr. 36/2023;
- të përmbajë deklaratë që nuk ekzistojnë pengesa sipas legjislacionit kundër mafies apo masa parandaluese, si dhe që nuk ka procedura falimentimi ose të ngjashme;
- të deklarojë se subjekti nuk është pjesë e organizatave me natyrë politike, sindikale apo fetare;
- të përmbajë angazhimin e sponsorit për të marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë, detyrimet dhe kostot eventuale lokale që lidhen me mesazhin promovues, në veçanti për ekspozimin e markës;
- të shoqërohet me pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale, duke nënshkruar dokumentin e bashkëngjitur “Njoftim për mbrojtjen e të dhënave personale”, në përputhje me Rregulloren e BE-së 2016/679, neni 13, dhe Dekretin Legjislativ nr. 196 të vitit 2003;
- të shoqërohet me vetëdeklarimin përkatës sipas modelit të bashkëngjitur “Dokumenti unik i kërkesave”, që vërteton mungesën e rrethanave që cenojnë ose kufizojnë aftësinë kontraktuese të sponsorit sipas neneve 94-98 të DL nr. 36/2023.

NENI 6 – PËRJASHTIMI NGA VLERËSIMI

Do të përjashtohen ofertat e kushtëzuara ose të shprehura në mënyrë të paqartë, ato pa nënshkrim, si dhe ato të paraqitura pas afatit të përcaktuar në këtë njoftim. Si datë pranimit e zarfit apo e korrespondencës elektronike do të merret për bazë vetëm vula e Ambasadës së Italisë në Prishtinë dhe data/ora e pranimit të mesazhit përmes postës elektronike. Dorëzimi në kohë i ofertave mbetet përgjegjësi e vetë dërguesve. Në rastin e ofertave të dërguara në formë fizike, Ambasada e Italisë në Prishtinë nuk mban përgjegjësi për vonesat që mund të vijnë si pasojë e shërbimeve të dorëzimit.

NENI 7 – VLERËSIMI DHE E DREJTA E REFUZIMIT

Ofertat për sponsorizim do të vlerësohen nga zyrat përkatëse, të cilat do të verifikojnë përmbushjen e kushteve nga ana e sponsorit dhe do të përzgjedhin subjektet me të cilat do të lidhen kontratat, duke u bazuar në parimin e ofertës më të lartë, më të favorshme ekonomikisht ose cilësisht më të përshtatshme. Propozimet për sponsorizim nuk janë detyruese për Ambasadën e Italisë në Prishtinë në lidhje me formalizimin e kontratës.

Ambasada, sipas gjykimit të saj të pavarur, duke respektuar parimet e efikasitetit në shpenzime, paanshmërisë, barazisë në trajtim, transparencës dhe proporcionalitetit, rezervon të drejtën të vlerësojë dhe, nëse është e nevojshme, të refuzojë, pa detyrim për të dhënë arsytim ndaj ofertuesit, çdo ofertë sponsorizimi, nëse paraqitet një nga rrethanat e mëposhtme:

- nëse vlerëson se mund të lindë konflikt interesi me veprimtarinë e saj;
- nëse konstaton se mesazhi promovues mund të dëmtojë imazhin e saj ose të nismave që realizon;
- nëse oferta konsiderohet e papranueshme për arsye të përgjithshme përshtatshmërie ose për shkak të mospërputhjes me legjislacionin italian për kontratat publike;
- nëse, për shkak të natyrës së sponsorizimit apo veprimtarisë së sponsorit, oferta bie ndesh me parimet e përgjithshme të rendit juridik italian, është e ndaluar me ligj, apo konsiderohet e papajtueshme me rolin institucional të Ambasadës ose me orientimet e politikës së jashtme italiane;

- nëse sponsorizimi lidhet me propagandë politike, sindikale, filozofike apo fetare, ose me forma reklamimi që përmbajnë mesazhe fyese, përfshirë shprehje fanatizmi, racizmi, urrejtjeje apo kërcënimi, si dhe në përgjithësi çdo përmbajtje që bie ndesh me ligjet dhe parimet e rendit juridik italian.

Ambasada e Italisë në Prishtinë rezervon të drejtën të tërhiqet nga marrëveshja për arsye të politikës së jashtme, me një kërkesë të thjeshtë, pa asnjë kusht apo kufizim, pa kosto, duke ruajtur të drejtën për kthimin e çdo pagese të bërë paraprakisht.

NENI 8 – LIDHJA E KONTRATËS SË SPONSORIZIMIT

Pas njoftimit nga Ambasada për dhënien e sponsorizimit, do të vijojë nënshkrimi i kontratës, me të cilën rregullohen marrëdhëniet ndërmjet sponsorit dhe Ambasadës. Në asnjë rast nuk lejohet që palë të treta të zëvendësojnë sponsorin në kontratë, përveçse me autorizim me shkrim nga Ambasada.

Më pas, sponsori do të dorëzojë, brenda afateve dhe sipas mënyrave të kërkuara, imazhin e logos ose markës së tij, do të ofrojë pa pagesë mallin e propozuar dhe/ose do të kryejë pagesën e kontributit financiar.

Nëse nga verifikimet e mëvonshme rezulton se përmbajtja e ofertave apo e vetëdeklarimeve nuk është e saktë, subjekti përkatës do t'i nënshtrohet sanksioneve penale të parashikuara dhe do të humbasë menjëherë çdo përfitim të mundshëm të marrë mbi bazën e deklarimeve të pasakta.

NENI 9 – PAMUNDËSIA E REALIZIMIT TË NGJARJES

Nëse, për shkak të rrethanave organizative të domosdoshme, bëhet e pamundur mbajtja e pritjes për Festën e Republikës, dhe kjo njoftohet zyrtarisht nga Ambasada përmes e-mailit të paktën 3 ditë para datës së caktuar për aktivitetin, përfituesi nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumave të paguara më parë Ambasadës.

Në këtë rast, Ambasada do t'i ofrojë përfituesit mundësinë që të zgjedhë aktivitete të tjera gjatë vitit për t'i sponsorizuar, me të njëjtat kushte si në ofertën e paraqitur.

NENI 10 – GJYKATA KOMPETENTE

Për çdo mosmarrëveshje është kompetente gjykata italiane në lidhje me zbatimin e kësaj thirrjeje dhe zbatimin e kontratës së sponsorizimit, kompetente është gjykata italiane.

Prishtinë, 26 mars 2026

Kjo thirrje është shpallur më 26 mars 2026 dhe publikuar në faqen zyrtare të Ambasadës (<https://ambpristina.esteri.it/al/>).

Aneksë:

- 1. Modeli i ofertës së sponsorizimit*
- 2. Informacion mbi mbrojtjen e të dhënave personale*
- 3. Vetëdeklarimi sipas modelit “Dokumenti unik i kushteve”*